

Udhëzime për diskutimet e grupeve të leximit

PREZANTIMI

Prezantimi bëhet nga personi që ka zgjedhur librin – personi flet për arsyet pse e ka rekomanduar dhe thotë diçka mbi autorin.

REAGIMET E PËRGJITHSHME EMOCIONALE

Këndvështrimet kryesore. A është libri tërheqës, i shpejtë apo i ngadaltë, befasues apo i pakuptimtë etj? Pse?

QËLLIMI I LIBRIT

Cili është qëllimi i librit, tema ose mesazhet kryesore dhe si jepen ato? A lë mbresa apo jo? Cilat janë zhvillimet apo skenat kryesore?

PERSONAZHET

Si janë zhvilluar personazhet? A janë të besueshëm? Si ndërveprojnë ata me njëri tjetrin? Cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të tyre? A e gjen ti vetveten te ndonjë prej këtyre pikave?

PIKAT E FORTA DHE TË DOBËTA

Aspektet e mira dhe të këqija. Çfarë funksionoi dhe çfarë nuk funksionoi. Sa me sukses është zhvilluar historia/ploti? Sa i fortë është fundi i tij dhe a është aq i mirë sa pritej? A ka ndonjë gjë të rëndësishme për strukturën apo stilin e të shkruarit? Si e ndihmojnë apo pengojnë këto leximin?

KRAHASO DHE BËJ KONTRAST

Ku qëndron ky libër krahasuar me librat e tjerë të të njëjtit zhanër/lloj ose të librave të të njëjtit autor?

EFEKTI I PËRGJITHSHËM

Çfarë ndjenje të lë libri? A ka në të ndonjë vijë paralele me përvojat e tua vetjake? A të ka bërë të mendosh ndryshe për diçka apo për dikë? A do të lexoje libra të tjerë nga i njëjti autor? Çfarë të thotë kjo për autorin?

NGA NJËSHI TE DHJETA

Mund të ishte ide e mirë që t'i kërkoje secilit prej pjesëtarëve të grupit ta rendisë librin nga njëshi te dhjeta. Mblidhni pikët dhe mbani një regjistër për të parë në fund të vitit se cili libër është fituesi i gjithë vitit.



